

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010) dhe nenit 7, paragrafi 4, nenit 13 dhe nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2017 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MJETET E PENSIONEVE DHE VLERËSIMIN E MJETEVE PENSIONALE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është të përcaktojë metodën dhe parimet e vlerësimit të mjeteve pensionale, si dhe mënyrën dhe afatin kohor në të cilin mbajtësi duhet të dorëzojë raportet në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, Fondin e Pensioneve, si dhe Siguruesve të Pensioneve dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).
2. Kjo Rregullore do të zbatohet për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, Fondet Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit dhe Pensionet Plotësuese Individuale (në vijim: fonde pensionale) dhe Drejtorët/Menaxhuesit e Mjeteve të Pensioneve.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (në vijim: Ligji për Fondet Pensionale) ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - 1.1. **“Portofol i aksioneve”** përfshin pjesën e aksioneve të fondeve pensionale, qofshin ato aksione të zakonshme ose preferenciale;
 - 1.2. **“Vlera e drejtë e tregut”** është çmimi i mundshëm që një blerës i interesuar për blerjen e asetit, do t’i paguajë shitësit të interesuar për shitjen e asetit. Për t’u caktuar vlera e drejtë e tregut supozohet se blerësi dhe shitësi kanë njohuri të arsyeshme për asetin në transaksion, veprojnë në interesin e tyre më të mirë, nuk veprojnë nën

presion ose ndikime të tjera nga jashtë dhe se është dhënë një afat i arsyeshëm për plotësimin e transaksionit;

1.3. **“Mjetet pensionale”**, përbëhen nga:

1.3.1. Mjetet që janë kategorizuar si pasuri investuese, dhe

1.3.2. Mjetet që nuk janë të kategorizuar si pasuri investuese e të cilat përfshijnë si vijon:

1.3.2.1. Paranë e gatshme;

1.3.2.2. Kontributet arkëtueshme, jo të vonuara më shumë se 18 ditë pas afatit, por vetëm nëse kontributet e tilla janë të përfshira në llogarinë individuale të pjesëmarrësve;

1.3.2.3. Pasuria jointestuese që ka për pronar fondin pensional dhe e cila është në kontroll aktual dhe posedim real (faktik ose të vërtetë) të tij dhe e cila është siguruar në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore;

1.4. **“Pasuria investuese”** i referohet interesit në tokë dhe/ose ndërtesë, që është zotëruar nga fondi pensional ose entitetet e tij të ndërlidhura nëse lejohen si investime direkte në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës ose ligjeve tjera të aplikueshme;

1.5. **“Pasuria jointestuese”** përfshin pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të siguruara nga fondi pensional nga pasuritë investuese;

1.6. **“Instrument financiar”** përfshijnë portofolet e aksioneve, investimet në bonde, borxhet dhe fletë obligacionet, si dhe të gjitha llojet (e pranueshme) të investimeve;

1.7. **“Instrumentet financiare afatshkurtra”** përbëhen nga paraja e gatshme, depozitat bankare, certifikata e depozitave, instrumentet e tregut të parasë dhe instrumentet të tjera që maturojnë brenda një (1) viti ose më pak nga data e vlerësimit;

1.8. **“Instrumentet financiare afat-mesme”** përfshijnë bondet qeveritare, bondet e korporatave, hipotekat, aksionet preferenciale më datë fikse të riblerjes dhe fonde të tjera që nuk janë lehtësisht të konvertueshme në kesh dhe të cilat maturojnë më gjatë se një (1) vit mirëpo më shkurt se pesë (5) vite nga data e vlerësimit;

1.9. **“Instrumentet financiare afatgjata”** janë të gjitha instrumentet financiare që nuk janë të kategorizuara si afatshkurtra ose afatmesme.

1.10. **“Mbajtës”** është një fiduciar që është bankë e licencuar dhe person juridik në Kosovë ose filial i një banke të huaj që është person juridik i licencuar për të kryer biznes në Kosovë nga BQK, ose është licencuar për të kryer biznes në cilindo shtet anëtar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik nga autoriteti mbikëqyrës bankar i atij shteti që ofron shërbime për ruajtje dhe depozitim të fondit pensional a

personave që sigurojnë pensione plotësuese individuale që lidhen me mjetet pensionale në bazë të marrëveshjes për ruajtje të tillë.

Neni 3

Ndarja e Mjeteve Pensionale

1. Fondet pensionale të cilat ofrojnë pension me kontribute të caktuara dhe pension me shuma të caktuara duhet t'i ndajnë mjetet e pensioneve dhe investimet përkatëse, si dhe kontabilitetin e veçantë në mënyrë të tillë që mjetet pensionale që iu takojnë pjesëmarrësve dhe përfituesve me pension të kontributeve të caktuara të jenë të ndara dhe të veçuara prej mjeteve, që u takojnë pjesëmarrësve dhe përfituesve me pension të shumave të caktuara.
2. Nuk duhet të ketë asnjë përzierje të mjeteve pensionale me kontribute të caktuara dhe atyre me shuma të caktuara lidhur me menaxhimin, investimin, kontabilitetin dhe mbajtjen e tyre.

Neni 4

Pasuria Joinvestuese si Pasuri e Fondit Pensional

1. Pasuria joinvestuese e mbajtur dhe e poseduar nga fondi pensional duhet të përfshihet si pasuri e fondit pensional nëse është përvetësuar nga:
 - 1.1.kreditë, hipotekat apo pengu si garanci pagese, dënimit ose borxheve të tjera gjatë aktiviteteve të tij investuese dhe/ose administrimit të programit të pensionit ose rregullimeve të tij;
 - 1.2.dhurimi, testamenti ose trashëgimia të cilat nuk vendosin kufizime. Në rast se dhurimi, testamenti ose trashëgimia imponojnë kufizime data efektive e përvetësimit për qëllimet e kësaj Rregulloreje është data kur përfundojnë kufizimet e vendosura.

Neni 5

Kufizimet mbi Posedimin e Pasurisë së Paluajtshme dhe të Luajtshme

1. Pasuria e paluajtshme e lejuar si pasuri e fondit pensional sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje nuk mund të mbahet për një periudhë më të gjatë se 2 (dy) vite nga data e përvetësimit.
2. Pasuria e luajtshme e lejuar si pasuri e fondit pensional sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje nuk mund të mbahet për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj nga data e përvetësimit.
3. Pavarësisht nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, me kërkesë të fondit pensional, BQK-ja mund të zgjatë afatin e mbajtjes së pasurisë së paluajtshme apo të luajtshme nëse sipas vlerësimit të saj, shitja me forcë e pasurisë mund të jetë kundër interesit të mirë të pjesëmarrësve dhe përfituesve të pensioneve.

Neni 6

Llogaritja e Mjeteve Pensionale për Pensionet me Kontribute të Caktuara

1. Mbajtësi duhet të bëjë llogaritjen e mjeteve pensionale për pensionet me kontribute të caktuara në baza ditore dhe mujore.
2. Llogaritja në bazë ditore e të ardhurave nga investimet e mjeteve pensionale duhet të bëhet në fund të çdo dite kalendarike duke e krahasuar vlerën e përgjithshme të mjeteve pensionale të ditës aktuale me vlerësimin nga dita paraprake. Ndryshimi i të dy vlerësimeve minus mjetet e vendosura apo tërhequra nga mbajtësi gjatë ditës paraqesin të ardhurat neto nga investimet për atë ditë.
3. Llogaritja në baza mujore e të ardhurave nga investimet e mjeteve pensionale duhet të bëhet në fund të çdo muaji kalendarik duke e krahasuar vlerën e përgjithshme të mjeteve pensionale të muajit aktual me vlerësimin nga muaji paraprak. Ndryshimi i të dy vlerësimeve minus mjetet e vendosura apo tërhequra nga mbajtësi gjatë muajit paraqesin të ardhurat neto nga investimet për atë muaj.
4. Norma e kthimit nga investimi i mjeteve pensionale është përqindja që rezulton nga përpjesëtimi i të ardhurave nga investimi me shumën e mjeteve pensionale që janë në mbajtje në fund të ditës apo muajit paraprak.
5. Fondet pensionale duhet t'i përshtatin të ardhurat nga investimi i mjeteve pensionale duke bërë përlllogaritje të ngjashme për mjetet e tjera pensionale që nuk janë tek mbajtësi në mënyrë që të arrijë deri tek të ardhurat totale nga investimi për shpërndarje për ditën apo muajin kalendarik përkatës.
6. Nëse shpenzimet nga aktivitetet investuese mbulohen nga të hyrat prej taksave me të cilat ngarkohen mjetet pensionale, kthimi neto nga investimi i mjeteve pensionale duhet përlllogaritur në parimin: kthimet bruto minus taksat e ngarkuara për investimin e atyre mjeteve.

Neni 7

Parimet për Vlerësimin e Mjeteve Pensionale

1. Mjetet pensionale duhet të vlerësohen në vlerat e tyre të realizueshme ose në vlerat e tregut sipas parimeve si vijojnë:
 - 1.1. Portofolet e aksioneve duhet vlerësuar sipas “vlerës së fundit të shitjes” së tyre të publikuar nga bursa në datën e tregtimit menjëherë para datës së vlerësimit. Aksionet pa vlerë të publikuar ku vlera e tregut nuk mund të matet lehtë duhet vlerësuar në vlerën e realizueshme neto të tyre.
 - 1.2. Instrumentet financiare afatshkurtra, përveç letrave me vlerë të qeverisë, duhet vlerësuar në vlerën e realizueshme neto. Letrat me vlerë të qeverisë duhet vlerësuar

në kohën e përvetësimit në vlerat e tyre të zbritura (diskontuara). Vlerësimet pas datës së përvetësimit duhet të bëhen në vlerat e amortizuara.

- 1.3. Instrumentet financiare afatmesme dhe afatgjata do të vlerësohen në vlerën amortizuese. Çdo ngritje ose zbritje që rezulton në vlerën e këtyre mjeteve është e amortizuar për fitim gjatë periudhës që ka mbetur deri në arritje të afatit.
- 1.4. Investimet në fondet e përbashkëta ose interesi i pjesëmarrjes në fondet tjera investuese duhet vlerësuar duke u bazuar në vlerat neto të mjeteve (VNM) të publikuara në datën e tregtimit menjëherë para datës së vlerësimit. Nëse vlerësimet e aplikueshme VNM nuk janë në dispozicion këto lloje të investimeve do të vlerësohen në vlerën e realizueshme neto.
- 1.5. Instrumentet financiare të blera në treg të hapur duhet vlerësuar duke u bazuar në vlerat përkatëse të realizueshme në datën e vlerësimit duke llogaritur dhe njohur ndryshimet e vlerave ndërmjet datës së tregtimit dhe datës së ujdisë.
- 1.6. Pasuritë investuese do të vlerësohen duke u bazuar në çmimet e publikuara dhe referencat tjera të besueshme në treg të hapur. Nëse këto baza të vlerësimit nuk janë në dispozicion, pronat investuese do të vlerësohen në mënyrën e parashkruar për vlerësimin e pronave jointestuese.
- 1.7. Pasuritë jo-investuese do të vlerësohen sipas vlerës së drejtë të tregut, siç është përcaktuar nga vlerësuesi i kualifikuar i pavarur, minus shpenzimet e arsyeshme të shitjes. Të gjitha pasurit e paluajtshme do të vlerësohen së paku një herë në vit. Vlerësimet duhet të bëhen më shpesh aty ku kushtet e tregut sugjerojnë se vlerat bartëse të mjeteve janë materialisht ndryshe prej vlerave në tregun e hapur.
- 1.8. Hipotekat dhe huazimet do të vlerësohen, duke mos e kaluar vlerën e tregut të hapur të fondeve të tyre kolaterale, në çmimin bartës pa provizion për obligimet në vonesa.
- 1.9. Nëse instrumenti financiar është ose bëhet joperformues, vlera e instrumenteve të tilla nuk duhet të jetë më e lartë se vlera e realizueshme neto.
- 1.10. Blerjet me dividendë ose me kamatë që përfshijnë aksionet ose instrumentet financiare të tjera duhet të vlerësohen pa përfshirjen e dividendit ose interesit derisa këta përbërës të të ardhurave në të vërtetë nuk pranohen.
- 1.11. Kontributet e arkëtueshme duhet të vlerësohen sipas kostos. Asnjë vlerë nuk duhet atribuuar për kontributet e arkëtueshme të cilat nuk janë paguar në afat prej 30 ditësh.
- 1.12. Për mobilet e zyrës dhe pajisjet nuk duhet të caktohet ndonjë vlerë.
- 1.13. Në caktimin e vlerave të pronës investuese, interesi dhe shkalla e zbritjes mund të rumbullakohen maksimum deri në 0,25%.
- 1.14. Mjetet jointestuese të pensioneve vlera e tregut të të cilave nuk mund të përcaktohet, mund të vlerësohen në vlerën e realizueshme nëse kjo e fundit është në dispozicion. Nëse në asnjë mënyrë nuk mund të përcaktohet vlera e tregut të mjeteve jointestuese të pensioneve, atëherë vlera duhet të përcaktohet duke përdorur vlerën e kostos së përvetësimit apo atë historike.
- 1.15. BQK-ja mund të lejojë baza të tjera për vlerësim që mund të jenë në pajtim me kërkesat e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE),

Bashkimit Evropian dhe/ose standardet e formuluar sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për vlerësimin e mjeteve pensionale.

Neni 8

Raportimi i Mbajtësit të Mjeteve Pensionale

1. Brenda 12 orëve pas fundit të çdo dite, mbajtësi duhet t'i paraqesë raportin ditor tek fondi pensional dhe listën e mjeteve pensionale nën mbajtjen e tij. Mbajtësi duhet të paraqesë raporte të veçanta për mjetet pensionale të kontributeve të caktuara dhe për mjetet e pensioneve me shuma të caktuara.
2. Brenda 10 ditëve të para pas fundit të çdo muaji kalendarik, mbajtësi duhet t'i paraqesë raportin mujor tek fondi pensional dhe listën e mjeteve pensionale nën mbajtjen e tij. Mbajtësi duhet të paraqesë raporte të veçanta për mjetet pensionale të kontributeve të caktuara dhe për mjetet e pensioneve me shuma të caktuara.
3. Raportet sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni duhet të përmbajnë informatat si vijojnë:
 - 3.1.paraqitjen e të gjitha mjeteve nën përkujdesjen e tij në fund të çdo dite apo muaji aktual dhe të ditës apo muajit paraprak duke treguar vlerat përkatëse në pajtim me parimet e përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje;
 - 3.2.llogaritjen e shkallës së të ardhurave të investimeve të mjeteve pensionale të kontributeve të caktuara që janë nën mbajtjen e tij.
4. Përveç raporteve të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, mbajtësi duhet të përgatitë të gjitha raportet e tjera, që mund të kërkohen sipas kushteve të marrëveshjes në mes mbajtësit dhe fondit pensional.
5. Mbajtësi duhet të paraqesë në BQK raportet dhe informatat mbi mjetet e pensioneve nën përkujdesjen e tij nëse kërkohen nga BQK-ja.

Neni 9

Shpërndarja e të ardhurave të investimeve në llogaritë individuale të pensioneve

1. Fondet pensionale që ofrojnë pensione me kontribut të caktuar duhet të shpërndajnë të ardhurat totale të investimeve të llogaritura në pajtim me nenin 6 të kësaj Rregulloreje në llogaritë individuale të pjesëmarrësve. Shpërndarja duhet të bëhet në pajtim me metodat e përshtatura nga fondi pensional.
2. Fondet pensionale që ofrojnë pensione me shuma të caktuara duhet të shpërndajnë të ardhurat totale nga investimet të llogaritura në pajtim me nenin 6 të kësaj Rregulloreje për financim të dispozitave teknike të kërkuara sipas kësaj Rregulloreje për pensione me shuma të caktuara.

Neni 10
Zbatimi dhe masat

Shkeljet e kësaj Rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara me Ligjin për Fondet Pensionale.

Neni 11
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregulla 6 mbi Mjetet e Pensioneve dhe Vlerësimin e Mjeteve të Pensioneve e datës 25 korrik 2002, si dhe çdo akt tjetër i BQK-së që bie në kundërshtim me këtë Rregullore.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci